



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 76, datë 22.06.2012

PËR
MIRATIMIN E DHËNIES SË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE
SIGURIMI PËR KLASAT E JO-JETËS

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/dh, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 31, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë “ANSIG” sh.a për ushtrim veprimtarie sigurimi për klasat e Jo-Jetës, përkatësisht klasat:

Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale).

Klasa 2: Sigurimi i sëmundjeve.

Klasa 3: Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina).

Klasa 5: Sigurimi i avionëve.

Klasa 6: Sigurimi i anijeve.

Klasa 7: Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve).

Klasa 8: Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 5, 6, dhe 7).

Klasa 9: Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6, dhe 7).

Klasa 10: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

Klasa 11: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

Klasa 12: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i anijeve (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve duke përfshirë përgjegjësinë e transportuesit).

Klasa 13: Sigurimi i përgjegjësisë civile të përgjithshme (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 10, 11 dhe 12).

Klasa 15: Sigurimi i garancive.

2. Licenca jepet për një periudhë pa afat.

3. Ngarkohet departamenti përkatës për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI